



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:068986
Datë: 14.02.2022
Numri i dokumentit: 02707802

PA1.nr.1015/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarit U. P. nga I, për shkak të veprës penale “Deklarim i rremë”, nga neni 392 par. 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), për të vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.25/2019, datë 04.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform të dispozitës së nenit 390 të KPP-së, me datë 08.02.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.186/18, datë 19.04.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.25/19, datë 04.06.2021, të akuzuarin U. P, e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale “Deklarim i rremë”, nga neni 392 par. 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sepse me datë 13.09.2018 rreth orës 08:4, në Pejë konkretisht pranë Njësitit të Trafikut Rajonal në Pejë, i akuzuari jep deklaratë të rreme, në atë mënyrë që i pandehuri pranë njësitit të lartcekur deklaroi se kinse në një aksident i cili kishte ndodhur në fshatin C. - Komuna e I. kishte pësuar lëndime trupore si pasojë e këtij aksidentit me qëllim të përfitimit material nga kompania e sigurimeve, pretendim ky i cili është vërtetuar se është i rremë nga CD-ja e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me çka kishte për kryer veprë penale “deklarim i rremë” nga neni 392 par. 1 të KPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në

barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Palët e dëmtuara eventuale, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike konform nenit 386 të KPP-së, duke propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së lartcekur, apo të anulojë aktgjykimin dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.1031/2021, datë 10.08.2021, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë, duke pretenduar që gjykata nuk bëri konstatimin e plotë të gjendjes faktike, ngase në të kundërtën nuk do ta lironte të akuzuarin nga akuza në rastin konkret, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar në tërësi nga provat materiale të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor si: procesverbali i vend shqimit të aksidentit dt. 14.10.2018, deklarata e dëshmitarit A. O., fotot e vendit të ngjarjes, konkluzioni i dhënë nga eksperti mjeko-ligjor N. H.. **Gjykata në rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, ndaj të akuzuarve është dashtë të marrë për bazë dhe të vlerësoj drejtë edhe rrethanat rënduese dhe atë rrezikshmërinë shoqërore si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre janë të shprehura mjaftë dhe janë në rritje e sipër. Me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve nuk do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, andaj edhe propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve të iu shqiptohet dënim me burg efektiv dhe dënim me gjobë më të lartë.**

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit, që i akuzuari të dënohet, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimeve më të ashpra, ndaj të akuzuarit. **Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata**

e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-së. Kështu gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarit mori pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykatë, moshën e re të të akuzuarve në kohën e kryerjes së veprës penale si dhe kohën e kaluar nga kryerja e kësaj vepre penale – mbi 6 vite, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti dhe në prezencë të këtyre rrethanave të akuzuarve i shqiptoj dënime kumulative (me kusht dhe gjobë), si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të prokurorit për rrethana rënduese nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarve të iu shqiptohen dënime më të ashpra – dënim me burg efektiv dhe dënim me gjobë më të lartë. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarve, moshën e re të të akuzuarve në kohën e kryerjes së veprës penale si dhe kohën bukur të gjatë (mbi 6 vite) nga kryerja e kësaj vepre penale, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.1015/21, më datë 08.02.2022

Zyrtarja ligjore,
Rrezarta Bala

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Kryetar i kolegjit,
Hashim Çollaku

Zyhdi Haziri